



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:066793

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05740643

KPPP.nr. 1316/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Zhuri” Sh.P.K., me numër unik identifikues 71238954 me seli në Prizren, përfaqësuar sipas autorizimit nga Alija Ajro, avokat nga Prizreni, kundër debitorit “Bashkimi Projekt” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810799504 me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Xhafer Tahiri, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 257/23, i lejuar me datë 31.07.2023, nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës me datën 27.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Bashkimi Projekt” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810799504 me seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 257/23, i lejuar me datë 31.07.2023, nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha, ANULOHET.
- II. DETYROHET kreditori “Zhuri” Sh.P.K., që, në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit “Bashkimi Projekt” Sh.P.K., shumën e përgjithshme prej EUR 156.00 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Zhuri” Sh.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës nr. 31032023002, e datës 31.03.2023, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 257/23, të datës 31.07.2023, me të cilin është urdhëruar debitori “Bashkimi Projekt” Sh.P.K., që, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 58,249.99, me kamatë vjetore 8%

nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbardim, si dhe shpenzimet e procedurës përmbardimore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbardim në shumë prej EUR 208.00, konform rregullores mbi tarifatat e avokatëve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbardimor, me arsyetim se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbardimor nuk i është dorëzuar asnjëherë debitorit, e njëjta nuk është pranuar dhe as që i është kërkuar debitorit përmbushja e kësaj fature para inicimit të procedurës përmbardimore. Tutje, ka shtuar se nuk ka arritur afati i përmbushjes të obligimit mes kreditorit dhe debitorit sepse një afat i tillë nuk është përcaktuar në faturë mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri dhe se e njëjta nuk është deponuar së bashku me propozim për përmbardim në origjinal. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej EUR 156.00.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë, duke theksuar se kreditori në mënyrë të ndryshme ka provuar që debitorit t'ia dorëzoj faturën objekt përmbardimi, por se i njëjti nuk ka pranuar as të takohet në mënyrë që të pranoj faturën, e cila i është dërguar pastaj përmes email zyrtar të debitorit. Ndërsa, ka shtuar se fatura përmban të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm, përfshi edhe afatin për pagesë. Në fund, ka theksuar se kreditori në propozim për përmbardim ka bashkangjitur edhe fletë dërgesat me të cilat vërtetohet se debitori i përmbardimit ka pranuar mallrat në mënyrë të rregullt, duke pranuar edhe fletë dërgesat, mirëpo që tani tenton ti shmanget detyrimit. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ashtu që urdhri përmbardimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbardimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, "*Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*", ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: "*Dokumenti i*

besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit monetar". Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: "*Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*".

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti i besueshëm, përkatësisht fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbardimor përmbardim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura e lartcekura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar pranë debitorit.

Gjykata ka vlerësuar edhe komunikimet elektronike të bashkëngjitura në propozim për përmbardim përmes së cilave kreditori ka pretenduar se fatura i është dorëzuar debitorit, mirëpo gjen se dorëzimi i faturës në adresën elektronike të debitorit, nuk mund të konsiderohet dorëzim i rregullt përderisa sa kreditori nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi se fatura është pranuar nga debitori, përkatësisht se i njëjti ka konfirmuar pranimin e email-it me përmbajtjen e faturës mbi bazën e së cilës është iniciuar procedura përmbardimore.

Poashtu, gjykata ka vlerësuar edhe fletë dërgesat e mallrave të cilat kreditori i ka bashkëngjitur në propozim për përmbardim, mirëpo gjeti se të njëjtat fletë dërgesa paraqesin eventualisht dëshmi na raport me pranimin e dërgesave mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se debitori është njoftuar me detyrimin monetar që buron nga fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbardimor dhe se është pajtuar me përmbajtjen e faturës dhe lartësinë e detyrimit të përcaktuar në të. Për më tepër, gjykata rikujton se procedura përmbardimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbardimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbardimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilën mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit organi përmbardues ka lejuar përmbardimin, nuk kanë tipare të përmbardueshmërisë, dhe rrjedhimisht edhe urdhri përmbardimor duhet të anulohet.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbartimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet debitorit në emër të prapësimit të ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar, në vlerë prej EUR 156.00, konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71, pika 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1316/23, datë 27.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.